



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “AtomMed” O.P. të datës 11.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit 616-24-1242-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “AtomMed” O.P. e datës 11.04.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit 616-24-1242-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “AtomMed” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “AtomMed” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 11.04.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.04.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “13 Furnizimi me materiale stomatologjike, laboratorike dhe RO kabineti” me nr. të prokurimit 616-24-1242-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Grupin e Operatoreve Ekonomik Medila-Humana O.P dhe Flamur Isufi B.I kan ofertuar me kompani tjera nga ato qe kan kerkuar AK. OE te shperblyer per kontrate i mungojne Autorizimet nga prodhuesit e Selectres (Elitech), Biobases dhe Keylab. I mungojne Declaration of Conformity te ketyre prodhuesve, dhe ISO Certifikatat e ketyre prodhuesve gjithashtu te cilet kan gene kritere primare per nje OE te pergjegjeshem".

Lidhur me pretendimet ankimore, fillimisht duhet sqaruar se pretendimet ankimore i referohen kërkesës në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

<p>Për llot IV Furnizim me reagjenta per biokimi per apraturat Selectra XS,S,M, Biobase, KeyLab 1.Deshmia nga Prodhuesi I Aparatit per reagensat e ofruar jane te pranushem ne kete aparat,qe posedojme pra Selectra XS,S,M, Biobase, KeyLab .</p> <p>2. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për shitjen produkteve qe jane objekt i kesaj kontrate ,Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i materialeve, reagjensave për futjen në qarkullim dhe shpërndarjen e tyre në tregje - sipas standardeve Europiane. (Origjinali apo të Noterizuar)</p>	<p>Për llot IV Furnizim me reagjenta per biokimi per apraturat Selectra XS,S,M, Biobase, KeyLab 1.Deshmia nga Prodhuesi I Aparatit per reagensat e ofruar jane te pranushem ne kete aparat,qe posedojme pra Selectra XS,S,M, Biobase, KeyLab .</p> <p>2. Autorizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për shitjen produkteve qe jane objekt i kesaj kontrate ,Operatori Ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i materialeve, reagjensave për futjen në qarkullim dhe shpërndarjen e tyre në tregje - sipas standardeve Europiane. (Origjinali apo të Noterizuar)</p>
--	--

Nga administrimi i dosjes së tenderit dhe ofertës së tenderuesit të rekomanduar për lot IV në këtë aktivitet të prokurimit, është gjetur se i njëjti ka dorëzuar autorizimet e prodhuesit sikurse është përcaktuar në dosjen e tenderit ndërsa pretendimet ankimore të parashtruesit nuk qëndrojnë. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.04.2024

  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.